



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 74, datë 29.07.2024



PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.99, DATË 30.03.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDIRI, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Raportit me nr. 8707/1 prot., datë 19.07.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Tabelën 3, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.03.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.31, Njësia Administrative Katund i Ri, rruga “Bisht Kamëz”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
9	FLORIAN TAFI	6	3+1
10	ZYHDI KURTI, HEKURANE KURTI, GENC KURTI, EDLIR KURTI, DALLENDYSHE KURTI	2	1+1
11	PETRIT KODRA	2	1+1
12	AGIM KODRA	9	3+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 446 prot.

Durrës, më 01.08.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.74 datë 29.07.2024 “Për miratimin e disa shtesave në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.03.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative katund i ri, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**